

GA RANTIMET E INAIL-IT

Njohja e një aksidenti ose sëmundjeje profesionale mund të sjellë dhënien e një rezultati në pikë për pasojat e përhershme, nga i cili mund të arrijë njohja ekonomike:

Për pasoja nga 6% deri në 15%: **kompensim i kapitalit,** pagesë njëherësh

Për pasoja nga 16% deri në 100%: krijimi i një **pensionit mujor**

EPASI TË KENI ARRITUR NJOHJEN NGA INAIL?

AKSIDENT

JU MUND TË KËRKONI DËMSHPËRBLIM PËR PËRKEQËSIM DERI NË **10 VJET** NGA NGJARJA

SËMUNDJE PROFESIONALE

JU MUND TË KËRKONI DËMSHPËRBLIM PËR PËRKEQËSIM DERI NË **15 VJET** NGA ANKESA



Inca Cgil ju shoqëron në rrugën tuaj të mbrojtjes, për njohjen e të drejtave tuaja

Ju mund të shkruani në adresën e mëposhtme: **infortuni@inca.it**

NA GJENI NË ADRESËN:



Duke punuar mund të SËMUREMI



Nëse mendoni se keni probleme shëndetësore të shkaktuara nga puna juaj, ejani në **Patronato Inca Cgil** dhe do të mund të arrini njohjen e garantimeve tuaja.

Në rast aksidenti ose sëmundjeje profesionale, **Patronati Inca Cgil** ju ndihmon në procesin e njohjes së garantimeve si pasojë e dëmtimeve të punës.



AKSIDENT NË PUNË DHE GJATË RRUGËS PËR NË PUNË

Nëse lëndoheni gjatë punës ose keni një aksident automobilistik gjatë rrugës nga shtëpia në punë, nga puna në shtëpi ose kur lëvizni nga një vend prodhimi në tjetrin,

Mbani parasysh që

është e rëndësishme të paraqiteni në Patronatin Inca me dokumentacionin e lëshuar nga Spitali (Emergjencia), për të filluar veprimet drejt Inail-it. Aty do të gjeni përvojë dhe profesionalizëm, si në fushën administrative ashtu edhe në atë mjekoligjore.

SËMUNDJE PROFESIONALE

Për t'u konsideruar profesionale, sëmundja duhet të haset për shkak dhe gjatë punës.

Rreziqet e pranishme në mjedisin e punës, me kalimin e kohës, mund të shkaktojnë dëme në shëndet:

- **DËMTIM TË SISTEMIT MUSKULAR E SKELETIK**

Përsëritja e lëvizjeve, ngritja manuale e ngarkesave, mbingarkesa e gjymtyrëve të sipërme, vibracionet, qëndrimet jo normale ose të sforcuara mund të shkaktojnë hernie diskale, sindromën e tunelit karpal, tendinopati në shpatulla, dëmtime të menisqeve etj.

- **KANCER PROFESIONAL**

Kimikatet dhe agjentët fizikë përbëjnë një rrezik të rëndësishëm për shëndetin e punëtorëve e të punëtoreve: pluhuri i drurit dhe lëkurës, rrezatimi ultraviolet, pesticidet, rrezatimet jonizuese janë faktorë që mund të shkaktojnë lloje të ndryshme kanceri: të mushkërive, të fshikëzës, të sinuseve paranasale, zorrës së trashë, gjirit, disa forma të leuçemisë, etj.

- **STRES I LIDHUR ME PUNËN**

Ritmet dhe organizimi i punës, kushtet mjedisore, konfliktet dhe ngacmimet mund të shkaktojnë stres dhe të manifestojnë çrregullime ankthi, pagjumësi dhe ndjenjën e papërshtatshmërisë në punë dhe, përveç kësaj, ndikojnë në vëmendje dhe rrisin rrezikun e dëmtimit gjatë kohës që jeni duke kryer punën tuaj.

Nëse mendoni se problemi juaj shëndetësor shkaktohet nga puna, në Inca do të gjeni staf ekspert dhe mjekë në gjendje të vlerësojnë rastin tuaj, të aktivizojnë rrugën për njohjen e **një sëmundjeje profesionale**.

